

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE TREGTARE "KINGSPAN ALBANIA Ltd" SH.P.K

Sot ne Tirane, ne daten 22.06.2011, ne baze te ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" dhe atij Nr. 9723, datë 3.5.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", me vullnetin e tyre te lire:

1. **Shoqeria KINGSPAN HOLDING NETHERLANDS B.V.**, me seli ne: Lingewei 8, 4004LL Tiel, Hollande, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Hollandez nen numrin 11023475 e perfaqesuar nga **Rigels Ikonomi** i biri i Janit, lindur me 02.03.1978, mbajtes i kartes se identitetit nr. 024518014, bazuar ne prokuren e perfaqesimit te shoqerise **KINGSPAN HOLDING NETHERLANDS B.V** te dt. 07.06.2011.

Ortaku i vetem i mesiperm me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "**KINGSPAN ALBANIA Ltd**" sh.p.k. me ortakte te vetem themelues shoqerine **KINGSPAN HOLDING NETHERLANDS B.V.**
Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.
Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit qe do te miratohet nga ortaket themelues.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane ne adresen : **Rr. Muhamet Gjollesha, Pallati "Ferlat", Kati 2, Tirane.**

Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar, dhe e fiton personalitetin e vet nga momenti i rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane.

NENI 5

Objekti i veprimtarise se saj do te jete:



- Tregti me shumice dhe me pakice, import-eksport i paneleve sanduic te gjitha llojeve qe sherbejne per ndertim objekte industriale, shtepi, vila, magazina, dhoma frigoriferike, fasada te ndryshme.
- Tregti me shumice dhe pakice, import-eksport i pajisjeve, mallrave, mjeteve dhe aksesoreve qe lidhen me zhvillimin, shfrytezimin, tregtimin e paneleve sanduic.
- Si objekt te veprimtarise se saj shoqeria do te ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 7.000.000 leke i ndare ne 100 pjese nga 70.000 leke dhe perbehet nga kontributi i ortakut te vetem:

KINGSPAN HOLDING NETHERLANDS B.V. me 100 % (100 pjese) te kapitalit, ose 7.000.000 leke.

Te gjithë pjesët e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Cdo pjese i takon e drejta e nje vote.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve themelues, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund t'u shesin te treteve pjesët e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht por pasi t'ua kene ofruar per blerje ortakeve brenda shoqerise me kushte jo me pak favorshme nga ato qe ju ofrohen te treteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakeve te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje **"KINGSPAN ALBANIA Ltd"** sh.p.k. Tirane, Albania.

NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

Asambleja e ortakeve

Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.



NENI 11

Administrator i shoqerise "KINGSPAN ALBANIA Ltd" sh.p.k caktohet: **OLTION ÇOTA**, i biri i Tafilit dhe i Shejnazes, lindur me 08.09.1977 ne Elbasan, me banim ne Rr. Agim Kuka, prane Freskut, Dajt, Tirane, mbajtes i letenjoftimit me nr.028885321 , per nje afat kohor 5 vjecar.

Administratori ka te drejte te administroje pasurine e shoqerise dhe te kryeje veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine dhe veprimtarine e shoqerise. Ortaket e shoqerise kane te drejta e detyrime te barabarta ndaj shoqerise e ligjeve.

NENI 12

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne propocion me pjeset e tyre ne kapitalin fillestar.

NENI 13

Ortaket dhe administratori kane te drejte te caktojne financier, likujdator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare te tre-mujorit, te 6-mujorit dhe vjetor per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 14

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kriterëve te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

NENI 15

Ky akt u perpilua ne prani te ortakeve duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire. Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte sejcila, per t'u depozituar ne QKR e per t'u shperndare ne organet kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU I VETEM

KINGSPAN HOLDING NETHERLANDS B.V.
Perfaqesuar nga Rigels Ikonomi

RIGELS IKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NO...465.....REP
NR 111 KOL

VERTETIM

Sot me date 22.06.2011(dymije e njembdhjete), ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje noteres Pranvera Karafili, me seli ne rruga "Zhan d'Ark" u praqit personalisht:

1. **RIGELS IKONOMI** I biri I Janit dhe Rajmondes , lindur ne Fier me 02.03.1978 banues ne Tirane , me profesion Avokat , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ,I cili mbane karten e identitetit Nr 024518014,I cili eshte perfaqesuesi ligjor I Shoqerise KINSPAN HODING NETHERLANDS B.V. me prokuren e posacme te dates 07.06.2011 Hollande , te cilit I konfirmoje neneshkrimin e vene sa mer siper , ne Akt Themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizur "KINGSPAN ALBANIA Shpk , dhe pasi u binda qe ai e nenshkroi me vullnet te lire e te plote e vertetova sipas ligjit.

NOTERE

Pranvera Karafili

